

PROCES VERBAL

Tipi i kontratës

Sherbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT:

Ndërtimi i platformës së inteligjencës artificiale si mjet mbështetës dhe analize për Operacionet e Operatorit të Shpërndarjes së Sistemit Energjetik (OSHEE).

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Platforma Komjuterike – 30211300 – 4.

VLERA E FONDIT LIMIT:

98,650,000 (Nëntëdhjetë e tetë milionë e gjashtëqind e pesëdhjetë mijë) leke pa TVSH ose 1,018,060 (Nje milion e tetemdhjetë mijë e gjashtedhjetë) euro pa TVSH, ***Sipas kursit zyrtar te dates 29.12.2025 ku 1 euro = 96.9 leke.***

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor OSHEE GROUP sh.a, ka hartuar proces-verbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim të vena ne dispozicion nga grupi i punes, caktuar me urdher titullari per kete proces, për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Në bazë të nenit 39, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor “OSHEE GROUP” sh.a. ka vendosur që kjo procedure te mos jete ne lote sipas arsytimit te meposhtem:

Aktualisht, OSHEE operon me sisteme të ndryshme që përfshijnë:

- **Sistemi i Billing/CRM** për menaxhimin e klientëve dhe faturimin
- **Sistemi Mobiread** për leximin e matësave përmes fotografive
- **Sistemi GIS** për menaxhimin gjeografik të infrastrukturës
- **Sistemi i Work Force Management** për koordinimin e ekipeve
- **Sistemi AMI (Smart Meters)** për leximin automatik të matësave

Objektivi i përgjithshëm i projektit është ndërtimi dhe implementimi i një platforme të integruar të Inteligjencës Artificiale, e cila do të shërbejë si mjet mbështetës, analitik dhe operativ për operatorët e OSHEE Group. Platforma synon të mundësojë:

- Mbështetje të vendimarrjes nëpërmjet analizave të avancuara dhe përpunimit inteligjent të të dhënave
- Sugjerime automatike dhe të personalizuar për proceset operacionale
- Konfirmim të detyrueshëm nga operatori për çdo veprim automatik që mund të ndikojë në proceset kritike
- Analizë dhe monitorim në kohë reale të sistemeve ekzistuese
- Raportim të vazhdueshëm dhe monitorim të performancës së proceseve dhe rekomandimeve

Platforma e Inteligjencës Artificiale do të funksionojë si një asistent inteligjent, i cili:

- Nuk zëvendëson vendimarrjen njerëzore, por e mbështet dhe e përmirëson atë
- Kërkon konfirmim manual përpara ekzekutimit të çdo veprimi kritik
- Ofron rekomandime të bazuara në analiza të dhënash, algoritme IA dhe modele prediktive
- Kryen monitorim të vazhdueshëm të proceseve operacionale
- Gjeneron insights të vlefshme për optimizim dhe përmirësim të vazhdueshëm

Qëllimi kryesor i këtij projekti është krijimi i istemit të Inteligjencës Artificiale (SIA) mbështetëse, Moduli AI - Aplikacioni Mobile për Leximin e Matësive, Moduli i Analizës së Sistemeve Ekzistuese dhe krijimi i infrastrukturës Fizike AI. Ndërtimi i kësaj platforme të integruar të Inteligjencës Artificiale që do të funksionojë si një mjet mbështetës dhe analize për operatorët e OSHEE.

Nisur nga procesi i kompleks i punës ky objekt nuk mund të ndahet në lote, pasi është e pamundur të ndash përgjegjësitë dhe Kohen e reagimit në rast problemi.

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas Shtojcës 10.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenin 26 dhe 30 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike për realizimin e objektit të prokurimit, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022, 2023 dhe 2024, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 98,650,000 (Nëntëdhjetë e tetë milionë e gjashtëqind e pesëdhjetë mijë) leke pa TVSH.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti / enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në Nenin 77, pika 3 e LPP, si dhe në Nenin 43, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar, ku përcaktohet se: Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar”

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Lloji i procedurës është “e hapur Sherbime – mbi kufirin e larte monetar” me mjete elektronike”, përcaktimi i vlerës së kërkuar është bërë në mbështetje të Nenit 43, pika 2, gërma” a” të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se:” Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohej operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

1. dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar”.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar të xhiros (jo më e vogël se 100% e vlerës së fondit) është Brenda marzhit të lejuar që mund të kërkohej. Gjithashtu për të stimuluar të gjithë operatorët e rinj që operojnë në treg si dhe për rritur numrin e konkurrentëve në kete procedure eshte gjykuar qe vlera e xhiros se kerkuar te jete minimalisht sa 100% e vleres se parashikuar te kontrates.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke u bazuar në Nenin 43, pika 1 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar, ku përcaktohet se: ”Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare”.

Ndër të tjera, përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke u mbështetur gjithashtu dhe në Ligjin Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", I ndryshuar, VKM Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet forms elektronike", Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", I ndryshuar.

Përkatësisht në miratimin e këtij kriteri është mbajtur në vëmendje neni 29 i Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore” ku përcaktohet se: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njejtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.2.2. Operatori Ekonomik duhet te kete nje aktivitet pozitiv te qendrueshem gjate 3 (tre) viteve te fundit 2022, 2023, 2024. Per te vertetuar plotesimin e ketij kushti Operatori Ekonomik duhet te paraqese kopje te balanceve te 3 (tre) viteve te fundit, te paraqitura ne organet tatimore dhe te konfirmuara nga ana e ketyre organeve gjithashtu te jene te shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve te nenit 41, pika”

c”, të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse bilanci janë në përputhje me parashikimet e nenit 43/4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, të ndryshuar, ku bilanci e dy viteve të njëpasnjëshme nuk duhet të kenë raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe Nenit 43, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilancave është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Referuar Nenit 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore “përcaktohet se:” Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilanci kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji”.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/2009: “*Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:*

i)totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrijn ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrijn ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".

2.3Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet të mëparshme të ngjashme për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 39,000,000 (Tridhjetë e nente milion) leke pa TVSH.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- *Për përvoja të mëparshme të realizuar me sektorin publik, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkohen vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe **shërbimet e realizuara.***

- *Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe **shërbimet e realizuara**”.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që përvoja të ngjashme të jenë në vlerën jo më shumë se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë faktin që të krijohen kushtet për një konkurrencë të hapur dhe për të mos minimizuar artificialisht numrin e operatoreve ekonomik që ofrojnë këto lloj përvojash, pavaresisht rendesise dhe kompleksitetit të objektit të procedurës të prokurimit, bazuar dhe në frymën e konkurueshmërisë që gjeneron LPP 162/2020 është gjykuar se vlera e kërkuar që OE ofertues të ketë realizuar me kontrata të ngjashme, të jetë nën 40 % e vlerës dhe në këtë mënyrë, AK ka sigurinë dhe besueshmërinë që OE ofertues do të jete realisht në gjendje të realizojë kontratën objekt prokurimi pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikonin në ecurinë e punës së AK, e cila ka në funksionim një seri sistemesh të nderlidhura dhe të informatizuara e teknologjise së lartë dhe me impakt shumë të madh financiar në rast bllokimi apo mos-funksionimi.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i certifikuar sipas standardeve ndërkombëtare ISO 9001:2015 ose ekuivalente të sistemit të menaxhimit të cilësisë (të vlefshme), ISO 27001:2022 ose ekuivalente për sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit (e vlefshme) dhe ISO 20000-1 ose ekuivalente për sistemin e menaxhimit të shërbimit të teknologjisë së informacionit. (të vlefshme).

Qëllimi i certifikimit të kompanisë duhet të jetë sipas fushës së objektit që do të prokurohet.

Çertifikatat të jenë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, sipas nenit 88 të VKM-285 datë 19.05.2021, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të punëve/mallrave/shërbimeve që do të marr përsipër të realizoj sipas akt-marrëveshjes paraprake

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që si kompani kanë kualifikimet/certifikimet e duhura organizative dhe operacionale të nevojshme për të zbatuar kontratën.

Konkretisht:

Kërkesa Lidhur me çertifikimin ISO 9001:2015 ose ekuivalent, na shërben për të na treguar sistemin e administrimit të shoqërisë, për të verifikuar dhe garantuar që OE i interesuar është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë në mënyrë cilësore dhe të plotë, bazuar në organizimin e brendshëm për menaxhimin sa më të mirë të cilësisë.

Përkatësisht kjo lloj ISO specifikon kërkesat për një sistem cilësor të menaxhimit të cilësisë, kur një organizatë:

- Duhet të dëshmojë kapacitetin për të siguruar vazhdimisht produktin që kënaq klientin dhe kërkesat statutorë dhe normative të aplikueshme.
- Synon të përmirësojë kënaqjen e klientit, nëpërmjet aplikimit të sistemit, duke përfshirë proceset për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit dhe garancisë të konformitetit me klientin dhe kërkesat statutorë dhe normative të aplikueshme.

Kërkesa Lidhur me çertifikimin ISO 27001:2022 ose ekuivalent shërben për të verifikuar dhe garantuar që OE i interesuar është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë duke siguruar që informacionet (siç janë ato që përmbajnë sistemet ekzistuese të AK dhe e kanë një rëndësi dhe konfidencialitet të lartë) të menaxhohen në mënyrë të sigurtë nga pikepamja informatike dhe të jenë të kontrolluara si dhe aksesimi i tyre të jete i verifikueshëm.

Kërkesa Lidhur me çertifikimin ISO 20000-1 ose ekuivalent shërben për të verifikuar dhe garantuar që OE i interesuar, siguron Autoritetin Kontraktor që të gjitha proceset (Levrim, instalim, etj...) që do të realizohen përgjatë kohëzgjatjes së kontratës, do të menaxhohen sipas standardeve më të mira të shërbimeve të teknologjisë së informacionit.

2.3.3 Operatori pjesëmarrës për të vërtetuar që ka kapacitete njerëzore profesionale të mjaftueshme për realizimin në kohë dhe sipas specifikimeve teknike objektin e prokurimit, duhet të vërtetojë se ka të punësuar ose me kontratë bashkëpunimi jo më pak se 10 (Dhjetë) punonjës të diplomuar në degët e Inxhinierisë Elektronike / Inxhinieri Informatike / Teknologji Informacioni / Informatikë / Informatikë Matematikë / Inxhinieri Matematike dhe Informatikë, Informatikë Ekonomike / Telekomunikacion / Inxhinieri Telekomunikacion ose ekuivalente, stafi të jete i vërtetuar me kontratë individuale pune midis paleve të vlefshme, diplomë përkatëse, Çertifikate perkatese si dhe të figurojnë në listepagesat e shoqërisë minimumi për muajin e fundit nga data e hapjes së ofertave, nga të cilët:

- a) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar si menaxher projekti ose ekuivalente
- b) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar në menaxhimin e mirëmbajtjes dhe SLA (ITIL) ose ekuivalente.
- c) Të paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar nga prodhuesi në sisteme Operimi OS (operating system), të nivelit associate/system administrator ose ekuivalente;
- d) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar nga prodhuesi për pajisjet server, të nivelit Arkitekt ose ekuivalent;
- e) Të paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar nga prodhuesi si specialist në fushën AI Foundation ose ekuivalent;

- f) Të paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar si programues. Certifikimet/Transkriptet duhet të jenë të lëshuara nga Microsoft/Oracle ose ekuivalente;
- g) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për DBA (Database Administrator) për administrimin e bazës së të dhënave;
- h) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për sigurinë e rrjetit ose ekuivalente.
- i) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar HTML, CSS dhe JavaScript ose ekuivalente;
- j) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për testues aplikacionesh ose ekuivalente.

Një punonjës mund të jetë i certifikuar në një apo me shumë certifikata të percaktuara si mësipërme.

Për të përmbushur këto kriter, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponueshmërinë në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit.

Lidhur me kërkesat që perfshihen ne formularin permbledhes te vetedeklarimit, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të 21 Shtuar me VKM 498/2024 22 Shtuar me VKM 498/2024 30 këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit dhe nenit 41 pika 4 paragrafet b) dhe c) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin minimal te nevojshëm për realizimin me sukses të kontratës.

Argumentimi teknik:

Me këtë numër minimal të kërkuar, me stafin që do të angazhohen në implementimin e projektit, synohet të garantohet gjatë gjithë kohës ofrimi i shërbimit dhe parandalohen rastet e pamundësisë së prezencës së stafit për arsye të ndryshme objektive (leje vjetore, raport mjekësor, trajnime, etj.).

Kriteri garanton AK për aftësitë profesionale të punonjësve që ka OE.

a) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar si menaxher projekti ose ekuivalente;

Argumentimi: Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar si menaxher projekti, për të siguruar zhvillimin e suksesshëm të projektit sipas standarteve dhe praktikave më të mira botërore duke marrë në konsideratë rëndësinë dhe kompleksitetin e projektit. Menaxheret e projektit janë përgjegjës për ndjekjen e të gjithë ciklit të një projekti implementimi, që prej analizës dhe dizenjimit të kërkesave, parametrizimeve dhe konfigurimeve të sistemit, testimit, trajnimit dhe dokumentimit të projektit. Projekt menaxheri, duke marrë parasysh kompleksitetin e projektit, afatet kohore të kryerjes së shërbimit, shumëllojshmërinë e shërbimeve të kërkuara, do të siguronte që çdo pikë e shërbimeve të kërkuara të kryhen me sukses dhe cilësi si edhe në kohë e afat sipas përcaktimeve të kësaj kontrate. Gjithashtu vlen të theksohet që me këtë numër minimal të kërkuar synohet të garantohet gjatë gjithë kohës

ofrimi i shërbimit dhe prandalohen rastet e pamundësisë së prezencës së stafit për arsye të ndryshme objektive (leje vjetore, raport mjekësor, trajnime, etj).

b) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar në menaxhimin e mirëmbajtjes dhe SLA (ITIL) ose ekuivalente.

Argumentimi: Kërkesa për një punonjës të certifikuar për "ITIL" lidhet me rezultatet që duhet të përmbushen nga Operatori Ekonomik, sipas kërkesave të shprehura në DST ku përcaktohen kohët e ndërhyrjeve dhe termat e tjera të nivelit të shërbimit SLA (shërbimet e mirëmbajtjes). Një certifikim ITIL është një set praktikash dhe kuadri rregullash dhe idesh për realizimin e shërbimit në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit, që është pjesë e qëllimit të projektit të autoritetit kontraktor. Kërkesa për certifikim ITIL, i dëshmon autoritetit që operatori ekonomik, nëpërmjet stafit të certifikuar si më sipër, garanton ideimin dhe konceptimin e shërbimeve IT të projektit në mënyrë të menaxhueshme sipas standardeve ndërkombëtare të njohura, në gjithë ciklin e tyre, përfshirë këtu dhe shërbimet e mirëmbajtjes.

c) Të paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar nga prodhuesi në sisteme Operimi OS (operating system), të nivelit associate/system administrator ose ekuivalente;

Argumentimi: Kjo kontratë ka për objekt ofrimin e shërbimeve të mirëmbajtjes së infrastrukturës fizike “hardware”, e cila përfshin AI GPU serverët. Një nga elementët kryesorë gjatë procesit të mirëmbajtjes së kësaj infrastrukture është sistemi operativ (Operating System – OS), i cili qëndron si shtresë bazë funksionale midis harduerit dhe aplikacioneve.

Sistemet operuese të këtyre pajisjeve janë të konfiguruar për të siguruar disponueshmëri të lartë 24/7, që do të thotë se ato duhet të jenë funksionale në çdo kohë, pa ndërprerje, për të garantuar vazhdimësinë e shërbimeve kritike që mbështeten në këtë infrastrukturë. Për të arritur këtë nivel sigurie, kërkohet ndërhyrje profesionale në mirëmbajtjen, monitorimin, përditësimin dhe zgjidhjen e problemeve të mundshme në sistemet operuese.

Për këtë arsye, është e domosdoshme që personeli që do të angazhohet të ketë kualifikimin e duhur profesional, i cili vërtetohet me certifikatat përkatëse të lëshuara nga prodhuesit e sistemeve operuese (si p.sh. Microsoft, Red Hat, Oracle, SUSE, etj.). Këto certifikime sigurojnë që inxhinierët kanë njohuritë dhe aftësitë teknike për administrimin e sistemeve operuese, konfigurimin e sigurisë, menaxhimin e përdoruesve, kontrollin e performancës, si dhe reagimin në situata emergjente që mund të prekin disponueshmërinë e sistemit. Ky kriter është i nevojshëm për sigurimin e cilësisë dhe qëndrueshmërisë së shërbimit të mirëmbajtjes, si dhe nuk cenon konkurrencën, pasi lejon çdo operator ekonomik të provojë kapacitetin teknik përmes certifikatave ekuivalente nga prodhues të ndryshëm të sistemeve operuese. Ai është gjithashtu në përputhje të plotë me Ligjin Nr. 162/2020, duke respektuar parimet e proporcionalitetit, konkurrencës dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë.

d) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar nga prodhuesi për pajisjet server, të nivelit Arkitekt ose ekuivalent;

Argumentimi: Kjo kontratë ka për objekt shërbimin e mirëmbajtjes së infrastrukturës fizike “hardware servers”, që përfshin serverët e bazës së të dhënave, serverët e virtualizimit dhe serverët e aplikacionit. Për shkak të natyrës së këtij sistemi, i cili është projektuar dhe konfiguruar për të siguruar disponueshmëri të lartë (High Availability) 24/7, çdo ndërprerje apo defekt harduerike mund të ketë impakt të drejtpërdrejtë në ofrimin e shërbimeve, duke ndikuar negativisht në funksionimin e sistemit të biletarisë dhe për pasojë edhe në të ardhurat financiare të sitit kulturor.

Në këtë kuadër, është detyrim profesional dhe teknik që operatori ekonomik të disponojë punonjës të certifikuar në nivelin më të lartë “Arkitekt” nga prodhuesi i pajisjeve server, të cilët zotërojnë njohuri të avancuara në:

- analizimin dhe diagnostikimin e problemeve të ndërlikuara të performancës ose të dështimit të sistemeve;
- planifikimin dhe zbatimin e masave për sigurinë dhe rikuperimin pas avarive (Disaster Recovery, Redundancy, Fault Tolerance);
- garantimin e vazhdimësisë së shërbimit dhe minimizimin e kohës së ndërprerjeve (downtime).

Rrjedhimisht, kërkesa për 1 specialist të nivelit Arkitekt është një masë proporcionale dhe e arsyeshme për të siguruar që shërbimi i mirëmbajtjes të kryhet nga personel me ekspertizë të lartë, në përputhje me kërkesat kritike të sistemit dhe me standardet ndërkombëtare të administrimit të infrastrukturës “enterprise-grade”.

Kriteri për punonjës të certifikuar në nivelin Arkitekt është teknikisht i arsyetuar, pasi garanton se mirëmbajtja e infrastrukturës kritike hardware do të kryhet nga specialistë të kualifikuar me kompetenca të avancuara për sisteme “mission-critical” që operojnë 24/7.

Ky kriter është në përputhje të plotë me Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, duke respektuar parimet e trajtimeve të barabarta, mosdiskriminimit dhe konkurrencës së ndershme.

e) Të paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar nga prodhuesi si specialist ne fushen AI Foundation ose ekuivalent;

Argumentimi: Kjo kontratë ka për qëllim ndërtimin e Platformës së Inteligjencës Artificiale (AI) si mjet mbështetës dhe analize për operacionet e Operatorit të Shpërndarjes së Sistemit Energjetik (OSHEE).

Për shkak të kompleksitetit dhe rëndësisë së këtij projekti, është tërësisht e domosdoshme që operatori ekonomik të ketë në personelin e tij specialistë të certifikuar në fushën e “AI Foundation”, të cilët zotërojnë njohuri të avancuara për arkitekturën, ndërtimin dhe implementimin e zgjidhjeve të bazuara në inteligjencë artificiale.

Ky projekt përfshin elementë kritikë si:

- projektimi i një arkitekture të qëndrueshme dhe shkallëzueshme të AI-së për përpunimin dhe analizën e të dhënave operacionale të OSHEE-së;
- ndërtimi i modeleve të mësimit makinerik (Machine Learning) dhe inteligjencës artificiale për parashikim, optimizim dhe asistencë vendimmarrjeje;
- integrimi i platformës AI me sistemet ekzistuese të OSHEE-së;
- menaxhimi i infrastrukturës së të dhënave (Data Infrastructure) dhe sigurimi i performancës së lartë gjatë trajnimit dhe ekzekutimit të modeleve.

Në këtë kontekst, specialistët me çertifikim në nivel “AI Foundation” (nga prodhues si Oracle, IBM, Microsoft, Google, Amazon, NVIDIA, etj.) janë thelbësorë për të:

- garantuar projektimin dhe zbatimin e saktë të komponentëve të inteligjencës artificiale;
- ndërtuar pipeline të të dhënave dhe modele të besueshme për parashikim dhe analizë;
- siguruar që algoritmet e AI të jenë të optimizuar, etikë dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare të sigurisë dhe performancës.

f) Të paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar si programues. Certifikimet/Transkriptet duhet të jenë të lëshuara nga Microsoft/Oracle ose ekuivalente;

Argumentimi: Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar si zhvillues programues për implementimin dhe mirëmbajtjen e zgjidhjeve software të cilat janë objekt i kësaj kontrate. Referuar kërkesave, natyrës dhe objektivit të kësaj kontrate, shërbimeve të kërkuara, detyrat specifike të ofruesit të shërbimit të ndarë në faza në përputhje me implementimin e projektit, shfaqet i nevojshëm zotërimi i stafit me kompetenca në Aplikacione në web.

g) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për DBA (Database Administrator) për administrimin e bazës së të dhënave;

Argumentimi: Përfshirja e të paktën 1 punonjësi të certifikuar për DBA (Database Administrator) për administrimin e bazës së të dhënave është e rëndësishme për sigurimin e integritetit, performancës dhe disponueshmërisë së të dhënave në një projekt. Këta profesionistë kanë njohuri të thella teknike në fushën e administrimit të bazës së të dhënave dhe mund të sigurojnë që infrastruktura e bazës së të dhënave të jetë e stabilizuar dhe e optimizuar për nevojat e projektit. Ata janë në gjendje të menaxhojnë sigurinë dhe mbrojtjen e të dhënave, duke implementuar strategji të sigurisë dhe duke monitoruar aktivitetin për të zbuluar dhe trajtuar rreziqe të mundshme për sigurinë. Përveç kësaj, punonjësit e certifikuar për DBA nevojiten për të optimizuar performancën e bazës së të dhënave, duke ndjekur praktikën më të mira dhe duke identifikuar dhe eliminuar shkaqet e mosperformancës. Kjo kontribuon në përmirësimin e efikasitetit dhe në garantimin e qëndrueshmërisë së sistemit të bazës së të dhënave gjatë gjithë jetës së projektit.

h) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për sigurinë e rrjetit ose ekuivalente.

Argumentimi: Bazuar në termat e references, infrastruktura rrjetit të sigurt kërkon jo vetëm konfigurimin e pajisjeve por edhe ekspertizën e nevojshme në implementimin dhe menaxhimin e politikave të sigurisë. Për implementimin dhe menaxhimin me cilësi të tyre është e domosdoshme që Operatori Ekonomik të ketë në stafin e propozuar personel për sigurinë e rrjetit.

i) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar HTML, CSS dhe JavaScript ose ekuivalente;

Argumentimi: Punonjësit e certifikuar sipas kriterit të mësipërm konsiderohen tepër të rëndësishëm për këtë projekt pasi puna e tyre do të konsistojë në përgatitjen e ndërfaqeve grafike që janë prezantimi i sistemit për përdoruesit. Ndërfaqet dhe paraqitja vizuale e tyre është një element shumë i rëndësishëm dhe konsiderohet një nga specifikat që kanë impakt të drejtpërdrejtë për përdoruesit e sistemit. Ndërfaqet janë kritike pasi ato shërbejnë si prezantimi i parë i ndërveprimit të përdoruesit dhe sistemit. Krijimi i ndërfaqeve të vlefshme dhe në përputhje me standardet dhe praktikën më të mira duke garantuar dhe realizimin e kërkesave të përcaktuara në termat e referencës do të mundësojë për AK që të rritet efienca e përdorueshmërisë së sistemit, do të sjellë vlerë të shtuar për imazhin e platformës si dhe gjithashtu do të rrisë nivelin e aksesueshmërisë së sistemit për përdoruesit pavarësisht formimit

j) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për testues aplikacionesh ose ekuivalente.

Argumentimi: Punonjësit e certifikuar për testues aplikacionesh kanë njohuri të thella për metodologjitë dhe mjetet e testimit e aplikacioneve, duke ndihmuar në zbulimin dhe parandalimin e gabimeve që mund të shkaktojnë kosto shtesë për AK. Me punonjës të certifikuar për testimin e aplikacioneve, mund të

sigurohemi që projekti është i sigurtë dhe siguron mbrojtje të duhur për të dhënat dhe informacionet e përdoruesve. Certifikimi për testimin e aplikacioneve shoqërohet me njohuri të specializuara për mjetet dhe teknologjitë e përdorura në testim. Kjo çon në efikasitet të rritur dhe në zbulimin më të lehtë të problemeve nëpërmjet përdorimit të teknologjive të specializuara. Vendorsja e këtij kriteri parashikohet nga AK në mënyrë që produkti përfundimtar që do të dorëzohet të ketë kaluar të gjithë testimet e mundshme të cilat kategorizohen në teste funksionalitetesh, teste sigurie dhe teste përdorueshmërie dhe të jetë validuar nga personel i certifikuar për këtë proces të rëndësishëm.

2.3.4 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë zgjidhjen teknike sipas kërkesave të parashikuara në Dokumentet e Tenderit.

Argumentimi: Ky argument është vendosur në lidhje me kriteret teknike dhe është në përputhje me Nenin 36 dhe Nenin 79 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Nenin 44 të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Argumentimi i specifikimeve dhe termave të references

Shënim: specifikimet teknike, për shërbimin objekt prokurimi, të cilat shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha shërbimeve dhe të pajisjeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e shërbimit, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku çdo referencë shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”, janë pjesë e DST e kesaj procedure.

Në specifikimet teknike, objekti i kontratës, nuk është përmendur asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve.

Shënim: *në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuar për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, në mbështetje të përcaktimit të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet që “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”, për rrjedhojë, ofertuesi i kualifikuar i pari, duhet të plotësojë sa më sipër.*